



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIK MALLAKASTËR

Ballsh më, 26.02.2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesues i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes: 14:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 12 anëtarësh. Të pranishëm nga administrata: Z. Fitim Bare, Z. Aleksandër Rama, Znj. Kleidja Hoxhaj, Z. Guri Nuhaj, Z. Izet Ymeraj.

Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 29.01.2026.
3. **Projektvendim Nr.09:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.10:** Për miratimin e raportit të performancës së Këshillit Bashkiak Mallakastër për vitin 2025.
5. **Projektvendim Nr.12:** Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
6. **Projektvendim Nr.11:** Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashikë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026, të ndryshuar.

Besoj e keni parë që në zarf, përveç projektvendimeve të rendit të ditës ka qenë dhe një projektvendim tjetër- **Projektvendim Nr.13:** Për miratimin e listës dhe fondin e bashkëfinancimit të familjeve që do të përfitojnë nga program i strehimit “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete e pafavorizuara”.

Nëse jeni dakord presim dhe 30 minuta, nëse vjen nsonjë këshilltarë tjetër, për të plotësuar kuorumin. Në këto kushte, me 9 anëtarë present, atëherë mbledhja ashtyhat për ditën e shtunë, ora 10:00, pra 28.02.2026.

Ballsh më, 28.02.2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesues i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes: 14:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 12 anëtarësh. Të pranishëm nga administrata: Z. Fitim Bare, Z. Aleksandër Rama, Znj. Kleidja Hoxhaj, Z. Guri Nuhaj, Z. Izet Ymeraj.

Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 29.01.2026.
3. **Projektvendim Nr.09:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.10:** Për miratimin e raportit të performancës së Këshillit Bashkiak Mallakastër për vitin 2025.
5. **Projektvendim Nr.12:** Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
6. **Projektvendim Nr.11:** Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026, të ndryshuar.

Në zarf keni pasur dhe **-Projektvendim Nr.13:** Për miratimin e listës dhe fondin e bashkëfinancimit të familjeve që do të përfitojnë nga program i strehimit “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete e pafavorizuara”. Kush është dakord me këtë rend dite? E hedhim në votim, votojnë 14 pro, 0 kundër, 0 apstenim. Miratohet.

Kalojmë te pika 2, sekretare të lutem na bëj me dije vendimet nga procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Vendim Nr.01: Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën me fondet e pushtetit qendror dhe vendor për vitin 2026.

Vendim Nr.02: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Vendim Nr.03: Për miratimin e listës së përfaqësuesve të Bashkisë Mallakastër në bordin e Institucionit Arsimor Mallakastër.

Vendim Nr.04: Për pagesën e vlerës së qirasë familjes së Z.Arjan Shehaj, banori fshatit Damës, Njësia Administrative Fratar, Bashkia Mallakastër.

Vendim Nr.05: Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026.

Vendim Nr.06: Për miratimin e një shtese e rishpërndarje të fondeve buxhetore për vitin 2026, nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025.

Vendim Nr.07: Për një ndryshim në vendimin nr.52 datë 23.12.2025 ‘për miratimin e financimeve të ndarë në tre vite’

Vendim Nr.08: Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026

Vazhdojmë me rendin e ditës,pikën 3 - Projektvendim Nr.09: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Z. Adrian Hazizaj : Nga qëndrori janë vetëm 31 persona që përfitojnë, kurse nga skema 4 dhe ish Nj.Ballsh 15 familje, po këto zonat e tjera , apo këta janë të pasur? Për shembull, nga qëndrori 12 familje kanë përfituar gjithsej.

Znj. Kleidja Hoxhaj: Fratari përmban tre Njësi Administrative prandaj atje ka një numër më të madh aplikimesh dhe bëhen referime, pastaj ato familje që dalin me pikë të pamjaftueshme skualifikohen nga vet sistemi, kurse për sa i përket Ballshit, shumica e aplikuesëve digjen për arsye se nuk pranojnë të aplikojnë te zyra e punës sit ë papunë.

Z. Adrian Hazizaj: Lajmëroni në të gjitha zonat.

Z.Qerim Ismailaj: Pjesa e familjeve që trajtohen rregullisht me ndihmë ekonomike, nuk aplikojnë te skema e 6%-it, janë 281 familje që përfitojnë te skema klasike.

Z. Nexhmi Sulaj: Atëhere e hedhim në votim,votojnë 14 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën katër të rendit të ditës; **Projektvendim Nr.10:** Për miratimin e raportit të performancës së Këshillit Bashkiak Mallakastër për vitin 2025. Besoj se e keni parë dhe skeni ndonjë kundërshtim, për dëgjesat që janë kryer, mbledhjet e komisioneve, çështjet e shumta që ka komisioni si detyrë, etj.

Z. Lefter Rabiçaj: Jemi dakord, s’kemi diskutime.

E hidhet në votim; votojnë 14 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet.

Z.Nexhmi Sulaj: Kalojmë në pikën gjashtë të rendit të ditës - **Projektvendim Nr.11:** Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026, të ndryshuar.

Z. Qerim Ismailaj: Në mbledhjen e muajit dhjetor bëmë diskutim për nryshimin e nivelit të pagave minimale do të bënim ndryshimet përkatëse, dhe në janar diskutuam këto ndryshime, dhe prap thamë që do të prisnim V.K.M. tjetër për indeksimin e pagave që do të prekte dhe strukturat, dhe ja ku jemi me këto ndryshimet tona. Në lidhjen 1 preket vetëm IV-4, në janar u prekën specialistët e IV-4 dhe IV-3, nga 70-72 mijë, dhe 60-65 mijë. Pra në administratë ka dy ndryshime, siç thamë që duke pritur V.K.M. do të bënim ndryshime, dhe

janë këto që do themi tani dhe magazinieri dhe topografi bënë këto shtesat te kolona e fundit. Niveli i pagave për policinë bashkiake, do t'i sqarojmë sepse ka pasur debate sepse nga 58 i lamë 57 sepse sipas V.K.M. shtesa pranohej vetëm me 10 mijë lekë ndryshimi. Kalojmë te lidhja 4, diferenca e pagave është me kufi minimal, edukatore me arsim të lartë nga 52-53 mijë, edukatore me arsim të mesëm kanë qenë. Sipas V.K.M. janë ndjekur dhe kuzhinierët dhe ndihmëskuzhinieret. Lidhja 5 dhe 6 janë të deleguara nuk bëjmë dot ndryshime bën përjashtim vetëm sekretari i shkollës së mesme. Lidhja nr. 8 është ajo që ka ndryshimet më të shumtat ndryshime, por jo në nivelit drejtues. Specialistët IV-4 dhe IV-3 njësoj si punonjësit e administratës së bashkisë. Pika 7 është reflektimi konform V.K.M 87, kemi planifikuar dhe gjykuar sipas vështirësisë së kushteve të punës, 4000 lekë për kushte dhe 15% për vështirësi pune. E njëjta gjë është reflektuar dhe për Nj. Ad. Aranitas dhe Hekal për specialistët. Doja të theksoja prapë atë ndryshimin nga 59 - 57 që mos të keni konstatime sepse e di që ka pasur debate, por duhet ta dini që efektet financiare janë nga 1 janari 2026.

Z. Adrian Hazizaj: - Lidhja 4 e projektvendimit të janarit është nga 59 mijë lekë, dhe në projektvendimin e këtij muaji vazhdon me këtë ulje në 57 mijë lekë.

Z. Qerim Ismailaj: Ju lutem a ju kam thënë që pritet të dalë V.K.M. e re për shërbimet mbështetëse dhe thamë ta reflektojmë në nivelin maksimal që mendonim, sepse në total janë diku te 13-14 veta, dhe s'ka punë vlere, por në bazë të V.K.M dhe të takimeve që kemi zhvilluar, sepse niveli i pagave që u ndryshua për të mbajtur proporcionin e pagave, sepse për ne s'ka peshë ajo 2 mijë lekëshi, por kaq ishte i mundur ndryshimi.

Z. Klodjan Shehaj: - Ka dalë V.K.M. 111 për nivelin e pagave, ka ndryshuar niveli i pagave, dhe a do të indeksohen kufijtë e pagave?

Z. Aleksandër ndryshime.Rama: Për nivelet drejtuese s'ka ndryshime.

Z. Qerim Ismailaj: - Indeksimi në pushtetin vendor e kemi me diapazon p.sh. 82 - 144 për përgjegjësit - 84 - 146 mijë lekë ose IV-4 nga 40 - 60 => 41 - 65, por kjo duhet të mbulohet nga buxheti i Bashkisë, përveç asaj 10 mijë lekëshit që mbulon pushteti qendror, por në pozicionet drejtuese i bëmë rritjet në muajin janar.

Z. Klodjan Shehaj: - Dakord jam, por V.K.M-ja thotë që indeksimi është për çdo nivel.

Z. Armand Hasanbashaj: Lidhja 8, pika 7, pozicioni 52800, dhe pika 14 - 51800, mekaniku ka vështirësi më tepër se shoferët.

Z. Qerim Ismailaj: - Kategoria V e punonjësit nuk është e përcaktuar nga ne, dhe luhet te vështirësia e punës e mjeteve të rënda s'është më e lehtë se mekaniku, ky është një fakt. Dhe në nivelin e tregut më tepër është shoferi i mjeteve të rënda sesa elektrikist ose mekanik. Është ruajtur raporti i shtesës për vështirësi.

Z. Armand Hasanbashaj: - Po, pse të mos jetë 15% dhe për këto të tjerat, pse e lë 10%?

Z. Qerim Ismailaj: - Është për maksimumin e stimulimit të këtyre pagave, ky është niveli maksimal pra.

Z. Armand Hasanbashaj: - Uli nivelin e shoferëve të administratës.

Z. Qerim Ismailaj: - Po le të rriten mo, dakord jemi, por tavanin nuk e ndryshojmë dot.

Largohet një anëtar nga mbledhja.

E hedhim në votim: 12 pro, 0 kundër, 1 abstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën pesë - Projektvendim Nr.12: Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.

Z. Naime Dervishaj: - Janë realizuar dëgjuesat publike dhe jemi në fazën e shpalljes për regjistrimin e anëtarëve. Kriteret janë:

* mosha 15-29 vjeç;

* të jenë banorë në teritorin e Bashkisë Mallakastër;

* të mos jenë drejtues të organizatave politike;

Rikthehet anëtari në mbledhje.

Numri i anëtarëve të këshillit vendor rinor është 1/3 e anëtarëve të këshillit bashkiak.

Z. Armand Hasanbashaj: - Do funksionojë ky këshill rinor, apo thjesht në letra?

Z. Lefter Rabiçaj: - Ju lutem mirëmbajuni ligjit, që të funksionojnë dhe mos të humbasë besimi në këto kriterë dhe zgjedhje që bëni, dhe këta të rinj që promovohen të kenë rol në shoqëri.

Znj. Suzana Malaj: - Ishin kriteret te projekt vendimi.

E hedhim në votim: votojmë 14 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Kalojmë në - **Projektvendim Nr.13:** Për miratimin e listës dhe fondin e bashkëfinancimit të familjeve që do të përfitojnë nga program i strehimit "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete e pafavorizuara".

Z. Bejkush Hoxhaj: - Në Njësinë Administrative Kutë vetëm një ka përfituar, kur është dhe Bilal Lushkaj, i cili mund të kishte përfituar.

Z. Oldison Caushaj: - Si është bërë procedura, si janë përzgjedhur, etj.

Z. Klodjan Shehaj: - Duam një sqarim për listën.

Z. Izet Ymeraj: Bashkia Malakastër ka ngritur grupin e punës për verifikimin e kërkesave që kanë ardhur deri në datën 10, çdo kërkesë ka pasur problemet e veta, pasi është bërë verifikimi janë mbajtur procesverbal, por duhet të dini dhe kushtet e objektit sepse një objekt që ka nevojë për rikonstruksion total, nuk e mbulon dot ky fond, dhe personat duhet të jetojnë në këto banesa jo të jenë largur, nëse keni ndonjë pyetje për persona specifik jam i gatshëm të përgjigjem. Ka dhe nga ata që jetojnë në Ballsh dhe kërkojnë konstruksion për banesat në fshat.

Z. Adrian Hazizaj: Po familje me anëtarë me aftësi ndryshe pse nuk kanë përfituar.

Z. Izet Ymeraj: - Po e dimë për kë thoni, po kemi vajtur te shtëpia i kemi kërkuar asaj vajzës të na sjellë dokumentet dhe nuk e sollën dokumentin që ju kemi kërkuar.

Z. Qerim Ismailaj: - Rasti që tha Bejkushi është më ekstrem, nr. i aplikimeve ka qenë 138 para se të hapej aplikimi nga Ministria e Financave. Por duhet të dini që sado mirë të bëjmë ne, kjo është një pjesë shumë e ndjeshme dhe prapë do të ketë pakënaqësi. Ne e kemi fituar dy herë këtë shërbim, por ka dhe abuzime në këto aplikime, ka nga ata që bëjnë një ndarje formale me fëmijët që të përfitojnë nga ky program. Nr. total i aplikimeve shkoi 180, por ne si bashki kemi 40% të këtij financimi dhe ne si bashki kemi lënë fondin 130

miljon lekë të vjetra, prandaj mbetemi në këtë numër përfituesish. Rasti që thotë Bejkushi është shumë vulnerabël. Është rasti i një banori në Greshicë që momentalisht jetojnë te ish qendra administrative, sepse janë të pastrehë. Por dhe këta që janë fitues mendoj se do i bëhet banesa nga themelet kur buxheti ishte vetëm 6 milionë lekë të vjetra për atë banesë. Për fondin që ne kemi janë 26 përfitues, por për ato familje që në bazë të kushteve që banesa e tyre ka, të mbulohet nga ky fond që kemi në dispozicion. Këto janë projekte konkurruese, dhe ne po e kalojmë me këshill për të qenë transparentë, këto dosje janë përcjellë në ministrinë përkatëse, por kjo listë do ndryshojë vetëm me heqjen e nr. 22 nga Greshica, dhe jemi në vazhdim të mbledhjes së dokumentacioneve. Por prapë se kemi sigurinë 100% nëse do jemi përzgjedhur, sepse brenda pesë viteve e kemi fituar dy herë këtë program.

Z. Nexhmi Sulaj: - Unë mendoj ta kalojmë që mos të bëhemi pengesë për të përfituar kjo shtresë, kurse përgjegjësinë morale le ta mbajnë këta që kanë bërë këto shkresa, të hiqet 22 dhe të shtohen dy emrat që thanë Bejkushi dhe Adriani.

E hedhim në votim, votojmë 14 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Mbledhja mbyllet këtu, me miratimin e të gjithë pikave të rendit të ditës. Faleminderit për pjesëmarrjen!

**MBAJTËS I PROCESVERBALIT
SEKRETARI I KËSHILLIT**

Zinaida Ahmetaj

